

**NË EMËR TË POPULLIT**

**GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ**, Departamenti i Përgjithshëm – Divizioni Penal, me gjyqtarin Mustaf Tahiri dhe procesmbajtësen Drita Ujupi, në çështjen penale kundër të pandehurit G.H. nga Ferizaj rr.”.....”, për shkak të veprës penale sulmi nga neni 187 par.1 të KPRK-së, i akuzuar sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Ferizaj PP/II.nr.1112-5/14 të dt.29.06.2015, pas mbajtjes së shqyrtimit gjyqësorë publik, në praninë e prokurorit të shtetit, Avdullah Abedini, të pandehurit G.H. si dhe të dëmtuarit L.M., më dt. 07.03.2016 morri, ndërsa me datë 27.03.2017 përpiloi me shkrim këtë:

**A K T G J Y K I M**

**I pandehuri:**

**G.H.**, nga Ferizaj rr.”.....” pn, data e lindjes....., në fshatin B., nga i ati V. dhe e ëma Xh., e gjinisë T., i pa punë, i gjendjes së dobët ekonomike, me nr. Personal. ...., shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës.

**ËSHTË FAJTOR**

Se me datë 29.04.2014, rreth orës 19.00 min, në rr. ”Vëllezrit Gërvalla”, në Ferizaj, pas një mosmarrëveshje lidhur me një telefon me dashje e ka përdorur forcën ndaj të dëmtuarit L.M., pa pëlqimin e tij, duke e goditur me grushte me kokë dhe në fytyrë disa herë.

**me ç’rast ka kryer veprën penale sulmi nga neni 187 par.1 të KPRK-së.**

Andaj gjykata në bazë të dispozitës së lartë përmendur dhe nen. 4,7,17,23,41,42.43,46, dhe 73 të KPK-së dhe nen. 365 të KPPK-së të pandehurin e,

**G J Y K O N**

**ME DËNIM NË GJOBË NË SHUMË PREJ 300 (treqind) €**, të cilin dënim është i obliguar ta paguaj 15 (pesëmbëdhjetë) ditë pas plotfuqishmërisë së aktgjykimit.

Në rast se dënimi me gjobë nuk mund të ekzekutohet në forma të tjera sipas nenit 46 të KPK-së, i njëjti do të shndërrohet në dënim burgu ashtu që për çdo 20 euro, do të llogaritet 1 (një) ditë burg.

I dëmtuari L.M. nga Ferizaj, ”.....”, ka deklaruar se hek dorë nga realizimi i kërkesës pasurore juridike.

Obligohet i pandehuri që në emër të paushallit gjyqësor të paguaj shumën prej 20 € në afat prej 30 dite nga dita e plotfuqishmërisë të këtij aktgjykimi nën kërcënim të përmbarimit me dhunë.

### **A r s y e t i m i**

Prokuroria Themelore në Ferizaj me akuzën PP.nr.1112-5/14 të dt.29.06.2015 ka ngarkuar të pandehurin V.B. nga Ferizaj për shkak të veprës penale lëndim i lehtë trupor nga neni 188 par.2 lidhur me nenin 1 nënpar 1.4 të KPRK-së dhe të pandehurin G.H. nga Ferizaj për shkak të veprës penale sulmi nga neni 187 par.1 të KPRK-së.

Gjykata me aktvendimin P.nr.773/15 të datës 07.03.2017 ka hudhë aktakuzën e PTH-së në Ferizaj PP.nr.1112-5/14 të dt.29.06.2015 ndaj të pandehurit V.B., për shkak se gjatë rrjedhës së procedurës penale është vërtetuar se i pandehuri ka vdekur.

Gjykata duke vepruar në këtë çështje penale ka caktuar shqyrtimin gjyqësor me dt. 07.03.2017 mbajti shqyrtimin gjyqësor ku prokurori i shtetit Avdullah Abedini lexoi akuzën, ndërsa në fjalën përfundimtare mbeti në tërësi pranë akuzës sa i përket të akuzuarit G.H. dhe kualifikimit juridik të saj, dhe i propozoj gjykatës që i akuzuari të shpallet fajtor dhe të i shqiptohet një sanksion penal i paraparë me ligj.

I akuzuari G.H., në shqyrtimin gjyqësor konform nenit 325 të KPP-së, ka deklaruar se nuk e pranon fajësinë për veprën penale për të cilën e ngarkon akuza duke shtuar se nuk e ka goditur askënd, përkundrazi është munduar që ti ndajë E.M. dhe V.B., duke shtuar se nuk e din se si ka ardhur deri te kjo zënkë pasi që ai nuk ka qenë i përfshirë në këtë, ndërsa sa i

përket raporteve me L.M. ka deklaruar se gjithmonë i ka pasur të mira e edhe tani i ka raportet e mira.

Gjykata bëri administrimin e provave si ato të propozuara nga përfaqësuesi i akuzës – prokurori i shtetit edhe ato të propozuara nga mbrojtja e të pandehurit.

I dëmtuari – dëshmitari L.M., në shqyrtimin gjyqësor ka deklaruar ai personalisht nuk ka pasur ndonjë mosmarrëveshje me tani të ndjerin V.B.. I dëmtuari ka deklaruar se data nuk i kujtohet por e di që djali i axhës së tij E.M. se bashku me tani të ndjerin V.B. dhe G.H. kishin shkuar tek shtëpia e tij dhe se menjëherë kishin filluar të përleshesh mes vete duke shtuar se nuk e din arsyen pse pasi nuk i kujtohet. I dëmtuari ka deklaruar se lidhur me këtë çështje ka dhënë një deklaratë në stacionin policor në Ferizaj, para se cilës deklaratë dëshmitarë ka deklaruar se i janë lexuar udhëzimet dhe detyrimet nga neni 125 dhe neni 129 i KPP-së dhe se të njëjtën deklaratë e ka nënshkruar. I dëmtuari – dëshmitari L.M. në shqyrtimin gjyqësor ka pranuar se në këtë deklaratë të policisë ka deklaruar se G.M. e kishte goditur në kokë me grushte nuk e di se sa here dhe po ashtu aty pastaj ishte bërë një tollovi dhe djali i axhës së tij është goditur me thikë të prehtë në krahun e majtë, dhe se arsyeja se pse kam deklaruar kështu në polici se me ka goditur G.H. me grusht në kokë është për arsyeje se në ato momente kam qenë i nxehur dhe i inatosur, mirëpo më vonë kam kuptuar se G.H. nuk e kishte goditur, por goditjet i kishte marrë nga tani i ndjeri V.B., duke shtuar se me të pandehurin G.H. tani ka raporte të mira dhe se janë shokë mes vete. Dëshmitari- i dëmtuari në shqyrtimin gjyqësor është ballafaquar nga prokurori i shtetit me deklaratën e tij të dhënë në Stacionin Policor në Ferizaj me datë 29.04.2015 dhe atë me pjesën e deklaratës së tij ku kishte deklaruar se “*unë L.M. deklaroj se sot me date 29.04.2014, deri sa isha në shtëpi ka ardhur djali i axhes tim E.M. me dy persona tek dera e shtëpisë, posa kam dale mua menjëherë me ka goditur G.H. me grushte në kokë – tri herë*”<sup>1</sup> dhe gjithashtu me pjesën tjetër të kësaj deklarate ku i dëmtuari L.M. kishte deklaruar se “*në pyetjen se kush të ka goditur ty personalisht i dëmtuari ishte përgjigjur me ka goditur G.H.*”<sup>2</sup>. I dëmtuari me rastin ballafaqimit me këto pjesë të deklaratës së tij ka deklaruar se e vërtetë është ajo çka po deklaroj sot në shqyrtimin gjyqësor e jo ajo çka kam deklaruar në stacionin policor, duke shtuar se ngjarjen me të freskët e ka tani në këtë shqyrtim gjyqësor se sa para tre viteve kur e ka dhënë këtë deklaratë në stacionin policor kur ka ndodhur rasti.

---

<sup>1</sup> Shih deklaratën e të dëmtuarit-dëshmitarit L.M. dhënë në stacionin policor në Ferizaj me autorizim të prokurorit me datë 29.04.2014.

<sup>2</sup> Po aty.

Gjykata po ashtu bëri prezantimin e provave si deklaratën e të dëmtuarit – dëshmitarit E.M. për të cilën është marrë aktvendim që e njëjta të lexohet pasi që i njëjti gjendet jashtë shtetit në Amerikë dhe se ardhja e tij në këtë shqyrtim gjyqësor tani për tani ishte e pa mundur<sup>3</sup>, e po ashtu edhe nga raporti i oficerit i datës 29.04.2014.

Me rastin e vlerësimit të dëshmisë së të dëmtuarit-dëshmitarit L.M. gjykata dëshminë e këtij dëshmitari- të dëmtuari e vlerësoji si pjesërisht të besueshme. Si të besueshme gjykata e vlerësoji deklarin e tij se atë ditë kishte ndodhur një mosmarrëveshje mes tani të ndjerit V.B., G.H.t, djalit të axhës së tij E.M. dhe të dëmtuarit L.M.. Si të besueshme e mori edhe deklarin e tij se kjo përleshje mes tyre kishte ndodhur para shtëpisë së të dëmtuarit L.M., se i dëmtuari ishte goditur me grushte në kokë dy-tre here, kjo pjesë e deklaratës së tij është e besueshme pasi që e njëjta është e mbështetur edhe në provat tjera materiale siq është deklarata e vetë të dëmtuarit dëmtuarit-dëshmitarit L.M. dhënë në stacionin policor në Ferizaj me autorizim të prokurorit me datë29.04.2014 si dhe deklarata e vetë të dëmtuarit dëmtuarit-dëshmitarit E.M. dhënë në stacionin policor në Ferizaj me autorizim të prokurorit me datë 29.04.2014.

Gjykata nuk e vlerësoi si të besueshme pjesën e deklaratës të dëmtuarit L.M. të dhënë në shqyrtimin gjyqësor kur ka deklaruar se goditjet me grushte nuk i kishte marrë nga tani i pandehuri G.H. por se këto goditje i ka marrë nga tani i ndjeri V.B.. Gjykata kësaj pjese të deklarin e tij në shqyrtimin gjyqësor e vlerësoji si jo të besueshëm, kontradiktor, se i njëjti me deklarimet e tij ne shqyrtim gjyqësor mundohet ta shfajësoje të pandehurin G.H. duke ja ngarkuar të gjitha veprimet tani të ndjerit V.B.. I dëmtuari L.M. gjatë dëshmisë së tij me rastin e ballafaqimit nga ana e prokurorit të shtetit me deklaratën e tij të dhënë në stacionin policor ishte kontradiktor, i njëjti në shqyrtimin gjyqësor ka pranuar se e ka dhënë në stacionin policor, ka deklaruar se u janë lexuar udhëzimet dhe detyrimet nga neni 125 dhe 129 të KPP-së, se të njëjtën deklaratë vetë e ka nënshkruar të njëjtën deklaratë e ka dhënë pa presion nga askush dhe se nuk ka qenë i maltretuar nga policia. I njëjti në këtë deklaratë ka deklaruar deri sa isha në shtëpi ka ardhur djali i axhës tim E.M. me dy persona tek dera e shtëpisë, posa kam dale mua menjëherë me ka goditur G.H. me grushte në kokë – tri here dhe se ishte goditur nga i pandehuri G.H., ndersa në shqyrtim gjyqësor ka deklaruar se nuk ishte

---

<sup>3</sup> Shih deklaratën e të dëmtuarit-dëshmitarit E.M. dhënë në stacionin policor në Ferizaj me autorizim të prokurorit me datë29.04.2014.

goditur nga i pandehuri G.H.. I njëjti këtë ndryshim të deklaramit të tij ndryshe nga ai I dhënë në stacionin policor e ka arsyetuar se “sot në shqyrtim gjyqësor e ka ngjarjen me të freskët se tani po i kujtohet me mire se para tre viteve kur e ka dhënë deklaratën në stacionin policor menjëherë po atë ditë kur ka ndodhur rasti”. Ky deklaram dhe ky arsyetim i të dëmtuarit-dëshmitarit L. M. është jo logjik, i pa arsyeshem, kontradiktor me vetveten, ku qartazi i njëjti dëshiron ta shfajësoj të pandehurin G.H., me të cilin edhe vetë i dëmtuari por edhe i pandehuri kanë deklaruar se kanë raporte të mira shoqërore dhe të gjitha veprimet inkriminuese tja mvesh tani të ndjerit V.B.. Andaj gjykata kësaj pjese të dëshmisë së dëshmitarit- të dëmtuarit e vlerësoj si jot ë besueshme, ngase është në kundërshtim me gjitha provat tjera materiale të administruara në këtë shqyrtim gjyqësor.

Gjykata gjithashtu vlerësoi edhe e mori në konsideratë edhe mbrojtjen e të akuzuarit, G.H. mirëpo gjykata një mbrojtjes së tillë nuk e vlerësoi si të besueshme, sepse mbrojtja e të pandehurit është kontradiktore, nuk është e mbështetur në prova dhe fakte, por më shumë është e orientuar nga fshehja e veprimeve inkriminuese me qëllim te shmangies nga përgjegjësia penale.

Vlerësuar nga aspekti juridik gjykata gjeti se në veprimet e të akuzuarit manifestohen të gjitha elementet e veprës penale sulmi nga neni 187 par 1 të KPRK-së të kryer në kohën, në mënyrën dhe rrethanat e përshkruara si në dispozitiv të këtij aktgjykimi ku i pandehuri G.H. pas një mosmarrëveshje lidhur me një telefon me dashje e ka përdorur forcën ndaj të dëmtuarit L.M., pa pëlqimin e tij, duke e goditur me grushte me kokë dhe në fytyrë disa herë.

Me rastin e caktimit të llojit dhe lartësisë së dënimit gjykata pati parasysht të gjitha rrethanat të cilat në kuptim të neni 73 të KPRK-së ndikojnë në përcaktimin e llojit dhe lartësisë së dënimit. Gjykata të akuzuarit si rrethana lehtësuese i mori parasysht faktin se i dëmtuari nuk i është bashkangjitur ndjekjes penale, se tani me të dëmtuarin L.M. kanë raporte të mira shoqërore, e në mungesë të rrethanave rënduese vlerësoi shkallën e përgjegjësisë penale dhe rrezikshmërinë konkrete të veprës penale duke i shqiptuar me gjobë si në dispozitiv të aktgjykimit me bindjen se një dënim i tillë është plotësisht i justifikueshem dhe në proporcion të drejtë në raport me peshën e veprës penale, shkallën e përgjegjësisë penale, rrethanave të kryerjes së veprës penale me bindje se me këtë lloj të dënimit, do të arrihet qëllimi ndëshkimor në kuptim të preventives speciale dhe asaj gjenerale i paraparë me nenin 41 të KPRK-së.

I dëmtuari L.M. nga Ferizaj, ”.....”, ka deklaruar se hek dorë nga realizimi i kërkesës pasurore juridike.

Obligohet i akuzuari që në emër të paushallit gjyqësor të paguaj shumën prej 20 /njëzetë/€, në afat prej 15 ditëve, nga data kur aktgjykimi të merr formën e prerë, nën kërcënimin e përmbarimit të dhunshëm.

Në bazë të së theksuarës më lartë u vendos si në disozitiv të këtij aktgjykimi.

**GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ,**  
**P. nr. 773/15, dt. 27.03.2017**

Sek.juridike  
Drita Ejupi

**Gjyqtari,**  
Mustaf Tahiri

**KËSHILLA JURIDIKE**

Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa në afat prej 15 ditëve nga dita e pranimin të tij, Gjykatës së Apelit në Prishtinë përmes kësaj gjykate.